



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:121784
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05649533

C.nr.366/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore te paditësit D.M. nga fshati..., Komuna Istog, te cilin sipas autorizimit e përfaqësoi B.M. avokat ne Peje, kundër te paditurës K.B..., me seli ne Prishtine Rr..., te cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi B.M. nga K.” S...”, me seli ne Prishtine, për kompezimin e dëmit material dhe jo material, pas përfundimit te seancës kryesor publike me dt.28.03.2024, jep këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit D.M..

II. Detyrohet e paditura B... me seli Prishtine, qe ne emër te kompensimit ti paguaj paditësit D.M..

Për demin jo material:

-ne emër te dhimbjeve fizike shumen prej-----4700€,
-ne emër te frikës se përjetuar shumen prej-----3800€,
-ne emër te dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim te aktiviteti te përgjithshëm jetësor ne shkalle prej 23.05% shumen prej -----9200€,
-ne emër te shëmtimit shkalla e mesme shumen prej -----3000€

Në shumë të përgjithshme prej 20.700 € (njëzet mije e shtatëqind euro) me kamatë ligjore 8% nga dita e gjykimit dt:28.03.2024 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

Për demin material:

ne emër për ushqim të përforcuar shumen prej -----750€,
ne emër te ndihmës nga personi i tjetër ne shume prej -----900€,
ne emër për shpenzimet e rehabilitimit fiziatrik-----420€
ne emër për shpenzimet e shërimit mjekësor shumen prej----- 279€,

Në shumë të përgjithshme prej 2349 €, (dymijë e treqind e katërdhjet e nëntë euro), me kamatë ligjore 8% nga data e ushtrimit të padisë 26.08.2020 e deri në pagesën definitive në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

III. Detyrohet e paditura B... që paditësit D.M. në emër të fitimit si pasojë e zvogëlimit të aftësisë punuese në formë të rentës të paguaj:

a) për periudhën kohore nga data e aksidentit dt:17.01.2020 e deri me dt:29.02.2024 shumën prej 9017.69 euro.

b) për periudhën e ardhshme nga dt:01.04.2024 e deri në rivlerësimin e aftësisë së përgjithshme punuese përkatësisht deri me dt:17.01.2026 rentën mujore nga 127.92 euro, e tutje deri sa për këtë të ekzistoni kushtet ligjore përkatësisht deri sa të bëhet rivlerësimi mjekësorë i paditësit nga eksperti për mjekësi të punës pas pesë (5) viteve nga aksidenti.

IV. Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit D.M. mbi shumën e gjykuara në pikën II të dispozitivit.

V. Obligohet e paditura që Byroja Kosovare e Sigurimit që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të paguaj paditësit shumën prej 2988.40 euro

VI. Obligohet paditësi që ta paguaj diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 80€ pasi që 20 euro janë të paguara në afat prej 10 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve.

Paditësi D.M. përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës B... për kompensimin e dimit material dhe jo material për shkak të lëndimeve të pësuar si pasagjer në aksidentin e trafikut të dt: 17.01.2020 në Rrugën rajonale Mitrovicë-Peje përkatësisht në fshatin... komuna Skenderaj, dhe aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia e ngasësit të pasiguruara i cili nuk iu është përmbajtur rregullave të komunikacionit rrugorë, me çrast si pasojë e aksidentit paditësi ka pësuar lëndime trupore.

Me parashtrësën e dt:27.03.2024 i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesë padisë për nga largësia ashtu që ka kërkuar në emër të kompensimit të dimit material për dhimbje fizike (trupore) për të gjitha format ka kërkuar shumën prej 7000 euro, për frikë shumën prej 7000 euro, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësorë shumën prej 16000 euro, për dhimbjet shpirtërorë për shkak të shëmtimit shumën prej 4000 euro, shpenzimet e mjekimit shumën prej 279 euro, për kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 1200 euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 1200 euro, për rehabilitimin fiziatrik shumën prej 900 euro, në emër të kompensimit të dimit material për fitimin e humbur si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të përhershëm punues përkatësisht rentës nga baza e autopergjegjshis për periudhën e kaluar nga data e aksidentit 17.01.2020 e deri me dt:29.02.2024 shumën prej 9017.69 euro, ndërsa për periudhën e ardhshme nga dt:01.04.2024 e deri me dt:17.01.2026 rentën mujore nga 127.92 euro deri sa për këtë të ekzistoni kushtet ligjore do të llogaritet renta pasi të bëhet rivlerësimi mjekësorë i paditësit nga

eksperti mjekësorë nga mjekësia e punës pas 5 viteve nga aksidenti, dhe te paguhet kamata ligjore ne shkallë prej 8% nga data e parashtrimit te padisë e deri ne pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoj duke i precizuar ne seancën kryesore për hartimin e padisë shumen prej 208 euro, për taksen gjyqësore shumen prej 21 euro, për precizimin e kërkesë padisë shumen prej 208 euro, për ekspertizën nga mjekësia e punës shumen prej 200 euro, për ekspertizën financiare shumen prej 200 euro, për ekspertizën mjekësore shumen prej 450 euro, dhe për 6 përfaqësime për një seance shumen nga 270.40 euro e ne shume 1622.40 euro, e ne shumen e përgjithshme prej 2909.40 euro.

Gjate shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari i paditësit ka qëndruar pran padisë dhe kërkesë padisë dhe ne fjalën përfundimtare ka theksuar se pas administrimit te provave vlerësimit te ekspertizave mjekësore , ekspertizës nga lëmia e punës dhe ekspertizës aktuale (financiare) konsideron se është vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë ne te cilin aksident trafiku paditësi ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale dhe bazuar ne ekspertizat ka bere precizimin e kërkesë padisë pran te cilës mbeti ne tersi dhe gjykatës i kërkoje qe te njëjtën ta aprovoi.

E paditura me përgjigje ne padi nuk e ka kontestuar bazën juridike por kontestuese mbetet vetëm lartësia e saje duke u bazuar ne raportin fillestar polisior përgjegjësi ne shkaktimin e këtij aksidenti ka vetura A, dhe ne ketë raste na takon legjitimiteti pasive si pale e paditur.

Gjate shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari i te paditurës ka qëndruar pran përgjegjës ne padi dhe deklarimeve nga seancat duke theksuar se me administrimin e provave për ketë çështje juridike civile baza juridike e kërkesë padisë për shakataret e aksidentit nuk është kontestuese ndërsa kontestuese është baza juridike sa i përket kërkesave për demin material te precizuar si ne parashtrësën e dt:27.03.2024 për format e demit material për ndihmën dhe kujdesin e personit te trete, shpenzimet për terapi fiziatrike, për këto forma – këto kërkesa te precizuara nuk kanë bazë ligjore juridike ngase për te njëjtat nuk janë prezantuar prova materiale veçanërisht kemi kërkesë për terapi fizikale ne shume prej 900 euro për te cilat nuk ka fatura dhe te njëjtën i propozoi gjykatës qe për këto forma te demit ta refuzoi kërkesë padinë e precizuar si te pa bazuar.

Precizimi i kërkesë padisë si ne parashtrësë hekë format e demit material te cilat janë tepër te larta ne shuma te precizuara janë te pa justifikueshme dhe ne kundërshtim me provat qe gjenden ne shkresat e lendes veçanërisht me ekspertizën mjekësore te grupit te eksperteve si dhe ekspertizat tjera mjekësore dhe te aktuaristikes dhe i propozomi gjykatës qe ofertën e dhëne ne shume prej 18000 mije euro ta aprovoi ndërsa precizimin e kërkesë padisë ne shumen prej 37000 mije euro te refuzoi si te pa bazuar mbi shumen e ofruar, ndërsa sa i përket shpenzimeve te procedurës kontestimore te kërkuara nga pala paditëse gjykatës i propozoi qe me rastin e vendosjes te ketë parasysh parimin e suksesit ne procedure.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar.

Për vërtetimin e drejt te gjendjes faktike ne ketë çështje juridike kontestimore dhe ne baze te propozimeve te palëve ndergjygjse gjykata gjate procedurës se provave administroi si prova: raporti i aksidentit nr.2020BR040 i dt:17.01.2020, kërkesa për shqyrtimin e rastit BKS-FK/243/2020 te dt:14.07.2020, kërkesa për kompensimin e demit e dt:18.02.2024, dëftesat e pagesave, flet lëshimi nr.444 i dt:17.01.2020 lëshuar nga klinika e kirurgjisë torakale, flet lëshimin me epikrizë nr.27/2020 i dt:18.01.2020 lëshuar nga klinika e anesteziologjisë dhe mjekimit intensivë, flet lëshimi nr.55/2020 i dt:30.01.2020 lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Maksilofaciale, ekspertiza mjekësore C.nr.366/2020 e dt:13.11.2023, ekspertiza nga mjekësia e

punës C.nr.366/2020 e dt:07.12.2023, ekspertiza nga mjekësia e punës C.nr.366/2020 e dt:02.02.2024 dhe ekspertiza aktuale C.nr.366/2020 e dt:15.03.2024.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndergjygjese dhe provave të nxjerra në kuqtim të nenit 8 Ligji i Procedurës Kontestimore me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha së bashku duke vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ne mes palëve ndergjygjese nuk është kontestuese fakti se aksidenti ka ndodhur me dt:17.01.2020 në rrugën Rajonale Pejë- Mitrovicë në fshatin... komuna Skenderaj, në të cilin aksident lëndime trupore kishte pësuar paditësi dhe nuk ishte kontestuese se lëndimet kishin ardhur si rezultat dhe rrethanave të cilat vërtetohen edhe përmes raportit të aksidentit nr.2020BR040 i dt:17.01.2020.

Po ashtu në mes palëve ndergjygjese nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesë padisë për kompensimin e demit material dhe jo material, por kontestuese në këtë çështje juridike është lartësia e kërkesë padisë së precizuar për të cilën i autorizuari i palës paditëse pretendon se është e arsyeshme dhe reale ndërsa e paditura pretendon se janë shuma tejet të larta, të pa argumentuara me prova materiale dhe jo në harmoni me praktiken gjyqësore.

Ekspertet gjyqësore Dr. Nj.H. –maksilofacial, Dr.A.B. –kirurg torakal, dhe Dr.Sh.M. –psikiatër në ekspertizën e hartuar me shkrime C.nr.366/2020 të dt:13.11.2023, duke u bazuar në provat materiale – dokumentacionin mjekësor në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejt për drejt të paditësit kanë dhënë mendimin profesional se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar këto lëndime: Dg. Polytrauma, Abdomen acutapp lienalis gr IV. Haematoperitone. Feac. Pars lateralis reg. Orbitalis I.dex. Fractura sinus maxillaris et oss zygomaticuslat. Dex. Fractura processus transversum costae nr. IV- VIII sin. Fractura costae nr.VI-X lat. Sin. OP: Laporatomia mediana supra et infraumbilicalis. Explorati cav. Abdominalis. Splenectomy. Lavage et drainage-Douglas. OP: Reposition sanguinea et osteosynthesis cum lamina metalici nr.II et scree VIII in reg infraorbitalis et zygomaticofrontalis lat ex. Dhe këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të renda trupore si pasojë e tyre në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjekësor paditësi ka pasur dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të renda 1 orë, me intensitet të renda 10 ditë, me intensitet të mesëm 8 javë, me intensitet të ulët janë prezentë edhe sot e kësaj dite, ka shëmtim truporë i shkalles së mesme për shkak të vrrajes- shenjës e cila gjendet në regjionin e kokës pjesë e jashtme parjetale, ka zvogëlim të aktivitetit jetësorë në shkallen prej 23.05 %, ka përjetuar frik primare e intensitetit posaçërisht të lartë deri në 3 sekonda, frik sekondare e intensitetit të lartë nuk mund të konstatohet pasi që i njëjti e ka humbur vetëdijen në sekondat e parë pas aksidentit, frik sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 6 javë, frikë sekondare e intensitetit të ulte vazhdon, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të 3 për 60 ditë, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 60 ditë, dhe rehabilitimi fiziatrik 2 here nga 14 ditë në vitin e parë.

Gjykata i falë besimin e plotë mendimin dhe konstatimin profesional të dhënë në këtë ekspertizë lidhur me lëndime trupore dhe pasojat e tyre pasi që është dhënë mendim profesional i qartë dhe i mbështetur në provat e lëndës të cilën ekspertizë nuk e kontestuan as palët ndergjygjese

Eksperti gjyqësor Dr.A.H. në ekspertizën mjekësore nga mjekësia e punës C.nr.366/2020 e dt:07.12.2023 për vlerësimin e aftësisë punuese për paditësin D.M. me rastin e aksidentit në trofikë në cilësinë e pasagjerit i shkaktuar me dt:17.01.2020 ka pësuar lëndime të renda trupore me pasojë të përhershme dhe kanë lidhje direkte kauzale me aksidentin si dhe ndryshimi- pasojë edhe në aftësinë punuese, andaj bazuar në profesionin e paditësit si agjustator që e ka ushtruar deri në aksident dhe atë nga dt:17.01.2020 e plotë një vitë deri me 17.01.2021 pa aftësi e

përkohshme dhe e plote për çdo lloje pune ka qene 100%. Shkaku hospitalizomi, trajtimi operativ – kirurgjikal ne mollëzën e djathte ne kafaze dhe ne bark, pozita e shtrire, dhimbjet, kujdesi nga personi tjetër.

Nga dt:17.01.2021 e 6 muajt e tjerë deri me dt:17.06.2021 pa aftësia akoma e përkohshme ka qene ne shkallë prej 50 % për shkak te dhimbjeve ne fytyrë, mollëzën e djathtë e sidomos ne kërrusje, ndërsa nga dt:17.06.2021 e deri ne ditën e ekzaminimit me dt:04.12.2023 edhe ne te ardhmen tani aftësia e përhershme për pune te agjastatorit është e zvogëluar ne shkallë prej 30% dhe është definitive, nuk priten ndryshime ne sanimin e mëtejme.

Konstatimin dhe mendimin profesionale i autorizuari i palës paditëse nuk e kontestoi ndërsa i autorizuari i palës se paditur e kontestoi me vërejtje duke propozuar ekspertize tjetër nga mjekësia e punës.

Ekspertja gjyqësore Q.R. nga mjekësia e punës ne ekspertizën C.nr.366/2020 e dt:31.01.2024 dhe sqarimet e dhëna ne shqyrtimin kryesore ka dhen mendimin profesional bazuar ne dokumentacionin mjekësor ne shkresat e lendes ekzaminimit e paditësit i cili ne aksidentin e trafikut me dt:17.01.2020 ka pësuar lëndime te renda trupore me pasoja e duke u bazuar ne tabelat e zvogëlimit te aftësisë punuese ne periudhën kohore nga dt:17.01.2020 e deri me dt:17.11.2020 pra për gjithsej 10 muaj ka qen 100%, janë kryer mjekime te mundshme ndërsa edhe për dy muaj te tjerë ka qen shkalla e zvogëlimit 50% pra për periudhën kohore 17.11.2021 ndërsa tutje vazhdon zvogëlimi i aftësisë punuese ne shkallë prej 30% e përhershme e bazuar ne literaturën shkencore nga mjekësi e punës, mirëpo kjo shkallë e zvogëlimit te aktivitetit te përhershëm mund te rishikohet me kërkesën ne afatin kohor prej 5 viteve.

Konstatimi dhe mendimi profesional te dhen ne këtë ekspertize palët ndergjygjjes nuk e kontestuan andaj gjykata i fali besimin e plote.

Ekspertja gjyqësore V.M. ne ekspertizën aktuale C.nr.366/2020 te dt:08.03.2024 ka konstatuar se duke u bazuar ne dokumentet dhe dëshmitë ne shkresat e lendes, faktorët relevant qe me kanë shërbyer për llogaritjen lidhur me kohëzgjatjen dhe lartësinë e zvogëlimit te aftësisë punuese paditësit i takon kompensimi për fitimin e humbur – renta për periudhën e kaluar kohore prej dt:17.01.2020 e deri me dt:29.02.2024 arrin vlerën prej 9017.69 euro ndërsa për periudhën e ardhme nga dt:01.04.2024 deri me dt:17.01.2026 renta mujore ne shume prej 127.92 euro apo e kapitalizuar vlera prej 2629.07 euro pra për te dy periudhat se bashku vlera totale prej 11.646.76 euro.

Gjykata i ka falur besimin e plotë ekspertizës aktuale te cilin nuk e kontestuan i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i te paditurës duke mos paraqitur as vërejtje.

3. Baza ligjore

Nga faktet e vërtetuara gjykata gjeti se ne rastin konkret gjen zbatim dispozitat e ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopergjegjsia dhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me nenin 183 parag .1 Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak te zvogëlimit te aktivitetit jetësor, te shëmtimit , te cenimit te autoritetit, te nderit te lirive ose te drejtave te personalitetit, te vdekjes se personit te afërm si dhe frikës, gjykata po te konstatoi se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetoni këtë do te gjykoi shpërblimin e drejt ne te holla pavarësisht nga shpërblimi i demit material, si dhe nga mungesa e demit material deri sa

ne parag 2, te po këtij neni është caktuar se me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e demit jo material si dhe për lartësinë e shpërblimit të tije gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të se mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim por edhe me atë se te mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Gjykata në kuptim të nenit 173 parag.3 i Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, vlerësoi se paditësi D.M. i takon e drejta e fitimit të humbur dhe e rentës për periudhën e ardhme nga dt.30.11.2017 e deri me dt.01.12.2018 e vlerësuar nga ekspertja përkatëse pasi që si pasojë e aksidentit ka zvogëlim të aftësisë punuese për çka iu është cenuar e drejta në realizimin e të mirave materiale e në veçanti në profesionin e tij deri në rivlerësimin mjekësorë pas 5 viteve përkatësisht me dt:17.01.2026

Pjesa e kërkesëpadisë në emër të ndihmës dhe përkuajdeset të huaj, në emër të ushqimit të përforcuar, konsiderohen si të arsyeshme dhe gjykata me bindje të lire e aprovoj këtë pjesë të kërkesëpadisë duke u bazuar në kushtet dhe standardin jetësor në Kosovë., në kuptim të nenit 323 të LPK.

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar gjykata erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj shumat e aprovuara në emër të dëmshpërblimit për demin jo material dhe material janë të arsyeshme dhe paraqesin një satisfaksion për paditësin.

Në lidhje me shumat e aprovuara gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi erdhi në përfundim duke u bazuar në dokumentacionin mjekësorë, ekspertizat mjekësore dhe ekspertiza aktuale.

Gjykata në lartësinë e aprovuar si në dispozitiv, paditësit ia njohu të drejtën në kamatë ligjore nga dita e vendosjes (gjykimit), për demin jo material që është vlerësuar lartësia e dëmit në të holla ndërsa për demin material nga data e parashtrimit të padisë , e deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD i Kosovës.

Me nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopergjegjësia është përcaktuar se kompensimi i demit material dhe jo material behet në pajtim me dispozitat e LMD.

4.Pjesa refuzuese

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesë padisë të paditësit respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara gjykata të njëjta i refuzoi si të pa bazuara ngase në baze të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë si dhe bindjes së gjykatës, del se kjo pjesë e kërkesë padisë së paditësit është e pa bazuar e mbi bazën e të lart cekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara në kërkesë padi përtej shumave të aprovuara nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen gjendjes faktike të vërtetuar për çka edhe kjo pjesë e shumës së kërkuar në kërkesë padi u deshtë të refuzohet si e pa bazuar.

5.Shpenzimet e procedurës

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 parag 2, Ligji i Procedurës Kontestimore si dhe në baze të tarifës së avokateve, ashtu që paditësit i aprovoi shpenzimet për padi shumën prej 208 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 100, për precizimin e kërkesë padisë shumën prej 208 euro, për ekspertizën nga mjekësia e punës shumën prej 200 euro, për ekspertizën financiare shumën prej 200 euro, për ekspertizën mjekësore shumën prej

450 euro, dhe për 6 përfaqësime për seance nga 270.40 euro, e ne shume prej 1622.40 euro, e ne shumen e përgjithshme prej 2988.40 euro.

Paditësi për taksen gjyqësore për diferencën e pa paguar gjykata bazuar ne vlerën e kërkesëpadisë se precizuar e obligoi si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 143 te Ligji i Procedurës Kontestimore vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.366/2020 me dt.28.03.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.